



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 49/2019 (JR)
Nr. 49/2 regj.

Tiranë, më 11.05.2021

SHPALLJE

E

NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se **ditën e mërkurë, datë 23.06.2021, ora 10.00**, do të gjykohet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh çështja me numër regjistri (JR) 49/2019, datë 09.10.2019, për ankimin e subjektit të rivlerësimit Alketa Nushi kundër vendimit nr. 172, datë 27.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Seanca në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykses përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesuese e Trupit Gjykses
Relatore e Çështjes
Gjyqtare
Gjyqtar
Gjyqtare

Ina Rama
Natasha Mulaj
Albana Shtylla
Ardian Hajdari
Rezarta Schuetz

Bazuar në nenin 49 pika 2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrimet me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim.

Bazuar në nenin 482 paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu dhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES
GJYQTARE

INA RAMA

